



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.137/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Hajriz Hoti kryesues, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, Anr.137/2025 e datës 23.01.2025.

II. Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 10,000.00 (dhjetëmijë) euro.

III. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 23.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën ka vërejtur se kandidati për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Dimal Basha, i cili në rrjetin e tij social facebook ka bërë një postim ku shprehimisht thotë se Oferta e 9 shkurtit e përmbledhur në një foto. Më tutje theksohet se ndër tjerash ka bashkangjitur një foto të ish kryeministrit Hoti që vjen nga radhët e subjektit politik LDK si dhe presidentit serb Aleksander Vuçiq. Sipas parashtresës së ankesës, me këtë rast i njëjti ka krahasuar subjektin politik LDK me një president serb, i cili në kohën e Luftës në Kosovë ka qenë Ministër i Informacionit në Qeverinë e Mirko Marjanovic dhe atë të kasapit të Ballkanit Slobodan Millosheviq, gjë e cila dihet botërisht të Subjektit LDK por edhe vërtetohet nga platforma Ëikipedia në Google. Në vazhdim theksohet se ky krahasim i deputetit Basha është gjuhë e nxitjes e urrejtjes, provokim i skajshëm, shkelje brutale dhe e rëndë e nenit 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili

shprehimisht thotë: 1.11. *përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon,, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë,, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundër të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë.*

Më tutje në ankesë thuhet se ky krahasim i partisë më vjetër në trojet mbarë shqiptare që është edhe barazim sipas fotos së bashkangjitur me një ish ministër që ka bërë thirrje për vrasje të shqiptarëve në Kosovë është shkelja më e rëndë që mbahet mend në histori të shkeljeve të ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, por që e njëjta e tejkalon edhe këtë limit.

Në ankesën e subjektit politik LDK ka përfshirë si rast precedent Vendimin e PZAP-it, Anr.28/2025, dt.15.01.2025, por në asnjë rrethanë për nga provokimet e urrejtja nuk mund të krahasohet me krahasimin brutal, të ulët, nënçmues, përbuzës që ka bërë kandidati për deputet Dimal Basha.

Si dëshmi për pretendimet e tij, paraqitësi i ankesës, ka bashkangjitur si provë fotografinë e printuar nga rrjeti social i kandidatit për deputet LVV.

Më datë 23.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 24.01.2025.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 23.01.2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), theksohet se fotoja e bashkangjitur përveç se përbën një rishpërndarje të fotografisë dhe pamjeve që kanë qarkulluar për shume vjet nga një takim i ish kryeministrit z. Avdullah Hotin me presidentin e Serbisë Vuqiq, nuk përbën shkelje nga neni 34 i LZP, për arsye se kjo dispozitë nuk sanksionon ri postimin e një fakti notor dhe një ngjarje e cila ka ndodhur e është publike, e cila poashtu nuk kontestohet as nga vet pala ankuese. Kandidati Basha nuk komenton asgjë e cila kategorizohet në nenin 34 siç pretendon ankuesi, duke përfshirë gjithashtu fotografitë të publikuara të cilat janë fakte notore të ndodhura në takimet e ndryshme gjatë negociatave dhe dialogut në mes të subjekteve përkatëse në fotografi. Lidhur me konstatimet nga pretenduesi se kinse deputeti Basha ka krahasuar subjektin politik LDK me Presidentin serb Vuqiq i cili sic përshkruhet në ankesë, në kohën e luftës ka qenë ministër i informacionit në qeverinë e Mirko Marjanoviq dhe të kasapit të Ballkanit Slobodan Milloshevic, nuk qëndron aspak për faktin se deputeti Basha në asnjë moment nuk ka komentuar e theksuar një gjë të tillë. Basha vetëm ka postuar një fakt notor gjatë një takimi publik të delegacionit kosovar me atë serb në Bruksel, andaj nga këto arsye ka propozuar refuzimin e ankesës.

PZAP, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

- *Ankesa është e bazuar*

Paneli, pas shikimit të bërë fotografisë së ofruar si provë materiale e cila është publikuar në rrjetin social të kandidatit për deputet të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) Dimal Basha, dhe se e njëjta foto nga hulumtimet e Panelit është vërtetuar se ekziston në rrjetin social të kandidatit në fjalë, prej nga rrjedh se ky postim ka për qëllim etiketimin e subjekteve tjera politike, dhe promovimit të subjektit politik LVV, e veçanërisht etiketimin dhe krahasimin negativ të subjektit politik, në atë mënyrë që përmes rrjetit social ka publikuar foto, përkatësisht

shpërndarjen në faqen e tij të rrjetit social foto, është bërë krahasimi i LDK-së me figurën e Aleksandër Vuçiçit.

Sipas Panelit vendosja emrit të partisë politike në foton e Aleksandër Vuçiçit, në kuadër të fushatës zgjedhore, konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimi i marrë në kohë të fushatës zgjedhore ka për qëllim të krijojë një lidhje negative ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe krijoj atmosferë tensioni dhe përçarjeje. Veprimi i tillë interpretohet si një përpjekje për të manipuluar perceptimin e votuesve, duke krijuar një lidhje negative mes një partie politike dhe një figure politike të përfolur. Kjo mund të shihet si një mënyrë për të përdorur figura të njohura për të stigmatizuar një subjekt politik dhe për të rritur ndjenjat negative kundrejt tij. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike. Përdorimi i figurave të tilla të përfolura mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë.

Përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LQP-së, me të cilën përcaktohet: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... 1) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*. Neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LQP-së thekson se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetë mijë (50,000.00) Euro.

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet të ngjashme.

Përveç të cekurave më lartë, Paneli me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin të pabazuara, të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore

si në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11, nenit 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nënparagrafi 1.3, të LZP-së, nenit 10 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A.nr.137/2025 më datë 24.01.2025

Kryesues i Panelit
Hajriz Hoxha



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.21/2025

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Beshir Islami dhe Muhamet Rexha, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, (LDK) me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që mbahen më datë 09 Shkurt 2025, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.137/2025, të datës 24.01.2025, në seancën e mbajtur me datë, 01 Shkurt 2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET si e pasafatshme ankesa e Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, (PZAP), A.nr.137/2025, të datës 24.01.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr.137/2025, të datës 24.01.2025, në dispozitiv është vendosur; I. Pranohet si e bazuar ankesa e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, (LDK), A.nr.137/2025 e datës 23.01.2025. II. Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 10,000.00 (Dhjetëmijë) Euro. III. Detyrohet Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Kundër vendimit të lartpërmendur, Subjekti Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke mos i specifikuar shkaqet e ankesës, ndërsa si pretendim kryesor e thekson gjobën e ulët të shqiptuar ndaj subjektit LVV, duke bërë krahasime për shkelje identike, duke theksuar se në një rast tjetër, PZAP-së, me vendimin tjetër krahasues e ka gjobitur subjektin ankues, LDK-në me gjobë më të lartë, për shkelje të Kodit të Mirësjelljes.



andaj kërkon nga Gjykata Supreme që të ndryshohet vendimi i PZAP nr. 137/2025 i datës 24.01.2025, dhe subjektit politik, LVV ti shqiptohet gjobë më e lartë.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore si të pa bazuara dhe propozoi që ankesa e subjektit politik LDK të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi A.nr.137/2025, të datës 24.01.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës, gjen se;

Ankesa është e pasafatshme.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 23.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën është gjetur se kandidati për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Dimal Basha, në rrjetin e tij social, Facebook, ka bërë një postim ku shprehimisht thotë se “Oferta e 9 shkurtit e përmbledhur në një foto”. Më tutje theksohet se ndër tjerash ka bashkangjitur një foto të ish kryeministrit Hoti që vjen nga radhët e subjektit politik LDK, si dhe presidentit serb Aleksander Vuçiq. Sipas parashtruesit të ankesës, me këtë rast i njëjti ka krahasuar subjektin politik LDK me një president serb, i cili në kohën e Luftës në Kosovë ka qenë Ministër i Informacionit në Qeverinë e Mirko Marjanovic dhe atë të kasapit të Ballkanit Slllobodan Millosheviq, gjë e cila dihet botërisht. Në vazhdim theksohet se ky krahasim i deputetit Basha është gjuhë e nxitjes e urrejtjes, provokim i skajshëm, shkelje brutale dhe e rëndë e nenit 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë të Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, PZAP-i, ka nxjerr vendimin A.nr.137/2025, të datës 24.01.2025, me të cilën e ka aprovuar ankesën e Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të vendimit të atakuar.

Kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës A.nr.137/2025, të datës 24.01.2025, Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka paraqitur ankesë. Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë çështje juridike fillimisht vlerësoi lejueshmërinë e ankesës dhe konstatoi se në këtë rast ankesa është e pasafatshme, për arsye se:

Me neni 118, paragrafi 4, të Ligji nr. 08/l-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcaktohet se: “ *Vendimi i PZAP-së mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP-ja, mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës*”.



Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata Supreme, vie në përfundim se, ankesa kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës A.nr.137/2025, të datës 24.01.2025, është e pa lejueshme për arsye se, dispozitat e cituara i referohen lejueshmërisë së ankesës të kushtëzuar përveç tjerash edhe me afatin për paraqitjen e saj i cili është dyzet e tetë (48) orë, nga pranimi i vendimit të PZAP-së.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Vendimin, A nr. 137/2025 të datës 24.01.2025, të PZAP-së, e ka pranuar me datë 25.01.2025, në ora 09:20h., ndërsa ankesën kundër këtij vendimi e ka dorëzuar në Gjykatën Supreme më datë 28.01.2025 në ora 10:50h, e që rrjedhimisht rezulton se ankesa është dorëzuar pas kalimit të afatit prej dyzet e tetë (48) orëve. Në këtë rast afati për paraqitjen e ankesës ka filluar të rrjedhë dhe llogaritet nga data 25.01.2025 ora 10:20h, ndërsa afati i fundit për paraqitjen e ankesës ka qenë 27.01.2025, ora 11:50h, prandaj në këtë rast, ankesa është e palejuar, për shkak se është paraqitur pas afatit ligjorë prej dyzet e tetë (48) orëve.

Nga arsyet e paraqitura më lart, e në bazë të nenit 118.4 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË

AA.nr.21/2025, më datë 01.02.2025.





REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUBSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës AA-21/2025
Oznaka spisa:

FLETËDËRGESE PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dërguar të bëhet dorëzimi i sa pas lënies së fajtorimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit mëdhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtësës, i qyt, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ina izvrši ni pošte ostavljenog pismenog obaveštenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena: odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (priblieno na vrata stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____ cas.
dana _____ u _____

Shkak i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijma _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

(Të panevojshmeve bëri vizë - nepotrebuje precirati)

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTIVIZIM DITË 01.02.2025

Numri i shojcave: _____
broj priloga _____

Vërtetohet se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)
Povrdjujemo prijem gorenavenog pisma
(i slovima)

01.02.2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primaoca ili licu koje je
pismeno primilo u zameni)

CR4
13:25

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

Në rast se marrësi është anuluar ose nuk është në gjendje të nënshkruajë
dorëzuesit, duke shkruar shkronja pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet.
Ako je primilac neprimljen ili nije u stanju da se potpis, potpisuje ga dostavljaoc.
napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.